

**TIRANA LOGISTIC PARK SH.P.K.**  
**AUTOSTRADA TIRANE - DURRES KM. 5, RRUGA GRYKA E KAÇANIKUT, MBRAPA FABRIKES COCA - COLA,**  
**TRUALL DHE NDERTESE NE ZONEN KADASTRALE 8320, PASURIA NR. 3/1387**  
**KAMËZ, TIRANË**  
**NUIS K81715012B**

---

**VENDIM**  
**i**  
**ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**  
**DATË 30.09.2020**

Sot, më datë 30.09.2020, në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë Tirana Logistic Park Sh.p.k. regjistruar më regjistrin tregtar me nr identifikimi K81715012B (më tej referuar si "Shoqëria"), me adresë Autostrada Tirane - Durres Km. 5, Rruga Gryka e Kaçanikut, mbrapa fabrikes Coca - Cola, Truall dhe Ndertese ne Zonen Kadastrale 8320, Pasuria Nr. 3/1387 u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **Balfin Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K72223031K dhe seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Kati 11, Tiranë, përfaqësuar nga administratori i saj Znj.Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 03.02.1983, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e lëtërnjoftimit me Nr. 034271384, - ortake e Shoqërisë dhe zotëruese e 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të saj

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Rozana Kodrari, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**RENDI I DITËS**

- I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**
- II. TË NDRYSHME**

\*\*\*\*\*

- I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË**

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm parashtron se Kapitali aktual i Shoqërisë është 1.753.608.030 LEK (një miliard e shtatëqind e pesëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e tetë mijë e tridhjetë lekë). Me qëllim mbulimin e humbjeve të akumuluar nga vitet pararendese është propozuar zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë me 58.081.913 LEK (pesëdhjetë e tete milion e tetëdhjetë mijë e nenteqind e trembedhjetë lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

**VENDOS:**

- A. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me 58.081.913 LEK (pesëdhjetë e tete milion e tetëdhjetë një mijë e nenteqind e trembedhjetë lekë).

- B. Kapitali i ri i shoqërisë do të jetë **1.695.526.117 LEK ( një miliard e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë milion e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë lekë).**

## II. TË NDRYSHME

Në lidhje me piken e dytë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm parashtron se vendimi e marrë në këtë mbledhje Asambleje të Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe për këtë qëllim

### VENDOS:

- A. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

\*\*\*\*\*

Megjenëse nuk ka çështje të tjera për diskutim, Ortaku i vetëm deklaron të mbyllur mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në orën 11:00.

\*\*\*\*\*

KRYETAR

  
Z. EDLIRA MUKA



SEKRETAR

  
ZNJ. ROZANA KODRARI